



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 588/15 Prot.

Tiranë, më 13.02.2025

VENDIM

Nr. 13 Datë 19.02 2025

**“PËR
MIRATIMIN E NJË SHTESE NË NUMRIN PËR PERSONEL AKADEMIK ME
KOHË TË PJESSHME NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË LËVIZJES, PËR
VITIN AKADEMIK 2024-2025
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në zbatim të nenit 49, pika 1, gërma (ç), të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", në VKM me nr.123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në VKM me nr. 243, datë 20.04.2023 "Për një ndryshim në VKM nr. 748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë", të ndryshuar, në VKM me nr. 329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", të ndryshuar, në Udhëzimin e MASR me nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet publike të Arsimit të Lartë", në Vendimin e Senatit Akademik me nr.13, datë 28.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimin e pagës për vitin 2025", si dhe në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.08, datë 29.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimin e pagës për vitin 2025", në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes me nr. 327/4 prot., datë 31.01.2025 "Kërkesë për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2024-2025 në FSHL", në Vendimin e Senatit Akademik me nr. 23, datë 13.02.2025 "Për miratimin e një shtese në numrin për personel akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, për vitin akademik 2024- 2025", Bordi i Administrimit në mbledhjen e radhës,

V E N D O S I :

1. Miratimin e 1 (një) shtese për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2024-2025, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes.
2. Efektet financiare mbuloohen nga granditë e ardhura nga MAS dhe të ardhurat e Universitetit.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit, si dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI

